

FM 050



PERSHKRIMI

Ngjitës çimento fleksibël, për ngjitjen e pllakave të qeramikës, grësit porcelani, materialeve të gurit natyral, artificial dhe të pjekura.

KLASIFIKIMI I PRODUKTIT

FM 050 është i klasifikuar si C2TE sipas EN 12004, bazë C çimento, 2 forcë e lartë ngjitëse, T rezistencë ndaj rrëshqitjes, E dhe me kohë të hapur të referuar.

KARAKTERISTIKAT

- Për përdorim brenda dhe jashtë.
- Lehtë për tu punuar.
- Mure të lyer brenda, duke u siguruar që piktura është lidhur mirë.
- Për ngjitjen e pllakave të qeramikës, grësit porcelani në sipërfaqe gipsi, pasi janë trajtuar me FM Primer.
- Pothuajse të gjitha shtresat e çimentos, mjafton të jenë të pjekura dhe të thata mjaftueshëm.
- Adhëzion e përsosur me të gjitha materialet që përdoren zakonisht në ndërtim.
- Mbivendosje pllakash qeramike mbi dysHEME ekzistuese.

FUSHA E ZBATIMIT

FM 050 mund të aplikohet gjithashtu në sipërfaqe deformuese, si p.sh.: pllaka gipskartoni ose druri, ngrohje dysHEMEJE, ku forcohet me aditivin Flexit. Në rastin e dysHEMEVE dhe veshjeve qeramike të jashtme, me dimensione mbi 900 cm², dysHEMEVE që duhet të fshihen në vend ose të ekspozuara ndaj ngarkesave të rënda, ose në rastin e aplikimit në pishina dhe basene për ujë, duhet të shpërndahet ngjitësi edhe në pjesën e pasme të pllakës për të siguruar përthithjen e plotë.

KARAKTERISTIKA TEKNIKE

Forma:	Pluhur
Ngjyra:	Gri, Bardhe
Sasia e ujit për hidratim:	7.5 litra për 25 kg
Temperatura e aplikimit:	Nga +5°C deri +35°C
Trashësia e aplikimit:	në 15 mm
Koha e punes:	Te pakten 4 ore
Koha e perpunimit:	45 min
Viskoziteti:	0,1 mm
Përmbushja e bashkimeve në mure:	Pas 8 oresh
Përmbushja e bashkimeve në dysHEME:	Pas 24 oresh
Forca e ngjitjes pas 28 ditësh në:	
• Kushtet normale:	≥ 1,53 N/mm ²
• Veprimi i nxehtësisë +70°C:	≥ 1,42 N/mm ²
• Zhytje në ujë:	≥ 1,55 N/mm ²
• Ciklet e ngrirjes-shkrirjes:	≥ 1,34 N/mm ²
Rezistenca ndaj temperaturës:	Nga - 30°C ne +90°C
Deformimi sipas EN 12002:	3,9 mm

MËNYRA E APLIKIMIT

Mbështetësit tradicionalë me bazë çimento duhet të kenë një kohë mjaftueshëm të pjekurimi (28 ditë në temperaturën 23°C dhe U.R 40 %). Mbështetësit duhet të jenë të sheshtë, të qëndrueshëm dhe të përshtatshëm për qëllimin e përdorimit. Mbështetësi ku do të aplikohet produkti duhet të jetë i pastër nga prania e materieve të tjera, si p.sh.: piktura, vajra, materiale kundër ngjitjes. Pastrimi bëhet në mënyrë teknike ose manuale. Para aplikimit të produktit, llaçet duhet të kenë një kohë pjekurimi prej të paktën 1 javë për çdo 1 cm trashësi. Mbështetësit duhet të jenë mekanikisht të qëndrueshëm, në varësi të qëllimit të përdorimit. Sipërfaqja e mbështetësit ku do të aplikohet produkti duhet të jetë e pastër nga çdo lloj materiali të jashtëm.

APLIKIMI

Për një aplikim të mirë të produktit dhe për të shfrytëzuar një shpërndarje të mirë dhe të barabartë në të gjithë sipërfaqen, rekomandohet që në fillim të hapni produktin mbi mbështetje duke përdorur pjesën e drejtë të frattazos dhe më pas me pjesën e dhëmbëzuar. Produkti duhet të aplikohet me një frattazo të përshtatshëm, në varësi të llojit dhe parametrevë të pllakës. Pas vendosjes së pllakës, rekomandohet të ushtroni pak presion mbi të për të mundësuar që edhe pjesa e pasme të lagështrohet plotësisht. Kushtet speciale si: temperatura të larta, erëra të forta, dielli ose mbështetje me nivel të lartë absorbimi uji, ndikojnë negativisht në punën e produktit, duke ulur ndjeshëm kohën e hapjes dhe korrigjimit. Prandaj, për të shmangur këto probleme, rekomandohet të spërkatni mbështetjen me ujë para aplikimit të ngjitësit ose ta trajtoni me FM Primer. Megjithatë, në çdo rast, është e rëndësishme që para vendosjes së pllakave, të kontrolloni nëse ngjitësi ka krijuar një shtresë. Në këto raste, duhet të shpërndani përsëri ngjitësin për të riaktivizuar forcën ngjitëse. Shmangni përdorimin e ujit mbi ngjitësin që ka formuar shtresën (kur është ngurtësuar), sepse në këtë rast krijohet një shtresë anti-ngjitëse. Në rastin e veshjeve dhe dysHEMEVE në mjedise të jashtme, sidomos kur pjesa e pasme e pllakave ka një sipërfaqe të lëmuar, rekomandohet të shpërndani ngjitësin edhe në pjesën e pasme të pllakës për të siguruar lagështimin e plotë.

RUAJTJA

12 muaj nga data e prodhimit nëse ruhet në paketimin e tij origjinal dhe të mbyllur, në zona të mbrojtura nga dielli dhe ngricat.

KONSUMI

4- 5 kg/m²

PAKETIMI

25 kg

